**URDHËR**
**Nr. 349/3, datë 24.11.2021**

# PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, "PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 4340, datë 22.10.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi "deri në datën 29.11.2021" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në datën 13.12.2021".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**